

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	23-vjeçari gjendet i pajetë në Durrës, shoqja ngre dyshime: Ka shumë mospërputhje, pse s'u bë autopsi a?
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392796.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 19:53:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	19 shtator 2026, 19:40:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 19 shtator 2026, 19:39:00 UTC → 19 shtator 2026, 19:41:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7367dca01d123e5eb0c3d359735b3cd67ad82da29f441360e193d67873b02d04
TEKSTI	576d1dc18469bb6c53a2788f17e472dbf3c3d5dca933875954ff1be432ce0201
PAMJA	5d80b8f89abe867528c7ff36b4902fbcf9084ad546710da2c30e8d8158c42778

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c7e0155ed45141442dfccfed82c65449159d4f6807ecb8595755c5f230e1088e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	236eb96fe169b4692e142b22588aed50ca0b168d3e0d8d3c079cd404682cbd2f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c7e0155ed45141442dfccfed82c65449159d4f6807ecb8595755c5f230e1088e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

23-vjeçari gjendet i pajetë në Durrës, shoqja ngre dyshime: Ka shumë mospërputhje, pse s'u bë autopsia?

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 19.09.2026, 21:40



Share



Share



Foto ilustruese e gjeneruar me AI

Një 23-vjeçar është gjetur pa shenja jete në banesën e tij në Durrës më 17 shtator, ndërsa rrethanat e vdekjes kanë ngritur pikëpyetje te një vajzë që thotë se ka qenë shoqe e të riut dhe se ka komunikuar me ish-partneren e tij pas ngjarjes.

Sipas njoftimit zyrtar të Policisë së Shtetit, më 17 shtator 2026, rreth orës 16:30, në lagjen nr. 14, Durrës, në banesë, është gjetur pa shenja jete 23-vjeçari me inicialet F.S., banues në lagjen nr. 15. Policia e ka cilësuar rastin si vdekje të dyshuar si vetëvrasje dhe ka bërë me dije se materialet i janë referuar Prokurorisë, ndërsa grupi hetimor, nën drejtimin e saj, vijon punën për dokumentimin e plotë të rrethanave dhe shkakut të ngjarjes.

Njoftimi është publikuar në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit më 18 shtator. Deri tani, ky është versioni zyrtar i bërë publik nga autoritetet.

Ndërkohë, JOQ Albania është kontaktuar nga një vajzë që prezantohet si shoqe e 23-vjeçarit. Ajo pretendon se ka disa pikëpyetje mbi mënyrën se si është trajtuar rasti dhe kërkon që autoritetet të sqarojnë nëse janë verifikuar të gjitha rrethanat përpara se të arrihej në përfundimin paraprak se bëhet fjalë për vetëvrasje.


Një pjesë e pretendimeve të saj lidhet me ish-partneren e 23-vjeçarit. Sipas shoqes, ajo ka shkuar në banesë pasi nuk ka mundur të kontaktojë me të riun dhe më pas ka njoftuar Policinë. Shoqja pretendon se vajza i ka treguar se e kishte gjetur 23-vjeçarin pa shenja jete dhe se, sipas saj, kishte deklaruar menjëherë se bëhej fjalë për vetëvrasje.

Pikërisht kjo është një prej çështjeve që shoqja kërkon të sqarohet: mbi çfarë informacioni është bazuar deklarimi i parë dhe çfarë ka konstatuar konkretisht personi që ka hyrë në banesë përpara mbërritjes së Policisë.

JOQ Albania disponon komunikime të vëna në dispozicion nga shoqja, në të cilat ajo pretendon se ish-partnerja ka përshkruar hyrjen në banesë dhe momentet pas gjetjes së të riut. Megjithatë, këto komunikime nuk mund të konsiderohen nga ne si provë për të përcaktuar se çfarë ka ndodhur realisht. Për këtë arsye, çdo deklaram i bërë në këto biseda kërkon verifikim nga autoritetet.

Shoqja ngre gjithashtu pikëpyetje mbi disa deklarime që, sipas saj, ish-partnerja ka bërë në lidhje me gjendjen ekonomike të 23-vjeçarit. Ajo pretendon se vajza ka folur për borxhe, mungesë parash dhe një shumë prej rreth 3 mijë eurosh, ndërsa shoqja thotë se këto pretendime nuk përputhen me atë që ajo di për jetën e të riut.

Sipas saj, 23-vjeçari punonte, kishte automjet dhe nuk kishte pasur problemet ekonomike që, pretendon ajo, janë përmendur nga ish-partnerja. Po ashtu, shoqja thotë se marrëdhëniet e tij me nënën dhe vëllain kanë qenë të mira, në kundërshtim me një tjetër deklaram që ajo pretendon se ka dëgjuar nga ish-partneria



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

Një tjetër pikë që ajo kërkon të verifikohet lidhet me pretendimin se 23-vjeçari i kishte kërkuar para ish-partneres një ditë përpara ngjarjes. Shojka pyet se mbi çfarë faktesh është bërë ky pretendim dhe nëse ekzistojnë komunikime apo të dhëna që e mbështesin atë.

Shojka ka vënë në dispozicion edhe materiale të tjera që pretendon se tregojnë komunikimet e saj me ish-partneren pas ngjarjes. Ajo pretendon se në disa raste përgjigjet e vajzës kanë ndryshuar dhe se disa prej deklarimeve të saj nuk përputhen me njëra-tjetrën. Këto janë pretendime të shoqes dhe nuk janë verifikuar në mënyrë të pavarur nga JOQ Albania.

Një tjetër element që ajo kërkon të sqarohet është aktiviteti i ish-partneres në rrjetet sociale pas ngjarjes. Sipas shoqes, vajza ka publikuar një material në TikTok dhe ka komunikuar me përdorues të tjerë, ndërsa në bisedat me të i ka thënë se ndodhej në gjendje traume dhe nuk e dinte se ku ishte.

Shojka e interpreton këtë si një mospërputhje dhe pyet nëse sjellja e saj pas ngjarjes është verifikuar nga autoritetet. Megjithatë, fakti që një person përdor rrjetet sociale apo komunikon pas një ngjarjeje tragjike nuk përbën në vetvete provë për ndonjë përgjegjësi apo për mënyrën se si ka ndodhur vdekja.

Edhe largimi i pretenduar i vajzës nga Durrësi pas ngjarjes dhe mungesa e saj në ceremoninë mortore janë përmendur nga shojka si elemente që e kanë bërë të dyshojë. Por edhe në këtë rast, JOQ Albania nuk mund t'i interpretojë këto veprime si prova për ndonjë përgjegjësi penale.

Pikëpyetjet më të rëndësishme lidhen me procedurën hetimore dhe jo me interpretimin e sjelljes së personave të përfshirë.

Shojka pretendon se nuk është kryer autopsi dhe se në trup nuk janë konstatuar shenja dhune. JOQ Albania nuk ka mundur të verifikojë në mënyrë të pavarur nëse është kryer apo jo autopsia, çfarë ekzaminimesh mjekoligjore janë realizuar dhe cilat prova janë administruar nga grupi hetimor.

Për këtë arsye, pyetjet drejtuar autoriteteve janë konkrete: A është kryer ekspertizë mjekoligjore apo autopsi? Nëse jo, përse është vlerësuar e panevojshme? Çfarë rezultatesh kanë dhënë ekzaminimet e kryera në trup dhe në vendngjarje? A është ekspertuar letra e gjetur në banesë dhe a është verifikuar nëse shkrimi i përket 23-vjeçarit?

Po ashtu, mbetet për t'u sqaruar nëse janë administruar dhe kontrolluar komunikimet e fundit të të riut, nëse janë verifikuar telefonat apo pajisjet elektronike të personave me të cilët ai ka pasur kontaktet e fundit dhe nëse janë marrë në pyetje të gjithë personat që mund të kenë informacion mbi orët para ngjarjes.

Një tjetër pikë që kërkon sqarim është kronologjia e hyrjes në banesë. Nëse personi që e ka gjetur të riun ka qenë i pari që ka hyrë në banesë, çfarë deklarimi ka dhënë ajo në Policinë e Shtetit dhe a është verifikuar në mënyrë të plotë versioni i saj për mënyrën se si ka hyrë, çfarë ka parë dhe çfarë ka bërë më pas?

Këto pyetje nuk nënkuptojnë se ndaj ish-partneres apo ndonjë personi tjetër ekziston përgjegjësi. Ato burojnë nga pretendimet e një personi që thotë se ka qenë i afërt me të riun dhe kërkon që të gjitha rrethanat të verifikohen.

Në fakt, vetë njoftimi zyrtar i Policisë së Shtetit thotë se grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon punën për dokumentimin e plotë të rrethanave dhe shkakut të rastit. Kjo do të thotë se hetimi, sipas autoriteteve, nuk është paraqitur si një çështje për të cilën janë mbyllur të gjitha verifikimet.

JOQ Albania i drejtohet Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë me kërkesën për të sqaruar publikisht, brenda kufijve që lejon hetimi, nëse janë kryer të gjitha ekzaminimet mjekoligjore, çfarë provash janë administruar, nëse janë verifikuar komunikimet e fundit të 23-vjeçarit dhe nëse është hetuar në mënyrë të plotë kronologjia e personit që e ka gjetur atë.

Në një rast të tillë, ajo që duhet të përcaktojë të vërtetën janë provat dhe ekspertizat e organeve ligjzbatuese, jo hamendësimet apo interpretimet e personave të përfshirë.

JOQ Albania mbetet e hapur për çdo sqarim zyrtar nga Policia e Shtetit, Prokuroria apo persona të tjerë të përfshirë, në mënyrë që çdo pretendim i ngritur në këtë shkrim të mund të marrë përgjigje dhe publiku të ketë një pasqyrë sa më të plotë të rrethanave të ngjarjes.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.